



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 25.07.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

#### VENDIM

#### PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË LIPJANIT

##### Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1.LTS Kosovo L.L.C me nr. biznestit 810810839 adresa Rr.Marigona Residence pn. Preoc-Graçanicë me pronar Ekrem Qerreti, shfrytëzues i pronës të paluajtshme të Komunës.

2.Prona e paluajtshme e Komunës, gjenden në ZK Konjuh, të përshkruar nga evidenca kadastrale përkatëse si në tabelën në vijim:

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m <sup>2</sup>
1.	Komuna Lipjan	P-71409036-00164-27	Konjuh	2500

3. Shfrytëzimi i pronës komunale do të jetë 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës komunale, destinohet kryesisht për realizimin e projektit për zgjerimin e portfolios së produkteve dhe ngritja e kapaciteteve prodhuese nga LTS Kosovo L.L.C

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspektionit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 462/01-35826

Lipjan, më 25.07.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

